

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Tabaku: A ndaluan shërbimet e NATO bashkëpunimin e kompanive italiane me Ron Yeffet e Kayo?
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/17/tabaku-a-kane-ndaluar-sherbimet-e-nato-bashkepunimin-e-kompanive-italiane-me-ron-yeffet-e-kayo/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 17:50:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 17:47:09 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3a3900db86dd5f8932c0fc1990773e6039d139f2ceb1ecf5490b0b9d1f2e9db6
TEKSTI	6ddbcbdd22d7fcece320deeb830b756288bdb83e8224d867fd44c23e3afae95eb
PAMJA	25c558bd002a9800b89f6b303764ea5b01d7279ac00ac8251e0a1889e548cc04

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1e56b1632ff549285ac2bc03418240d091e18f49f2ec7394b4aa18de972eab69
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a0e62f20f1566f1a6ab80e6e4e50c1c4744bc54a84695e6ceb27bc326e386c4d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1e56b1632ff549285ac2bc03418240d091e18f49f2ec7394b4aa18de972eab69>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Tabaku: A ndaluan shërbimet e NATO bashkëpunimin e kompanive italiane me Ron Yeffet e Kayo?

19:47 : 17/09/2026 në AKTUALITET, POLITIKE



Deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku, ka ngritur pikëpyetje mbi mënyrën se si është zhvilluar bashkëpunimi mes kompanisë KAYO, biznesmenit Ron Yeffet dhe kompanive italiane në sektorin e mbrojtjes.

Gjatë fjalës së saj në Kuvend, Tabaku iu drejtua ministrit të Mbrojtjes, **Ermal Nufit**, duke kërkuar të dijë nëse kompanitë italiane që kanë zhvilluar bisedime me qeverinë shqiptare janë kushtëzuar që të bashkëpunojnë me **KAYO-n** dhe **Ron Yeffet**.

“A është e vërtetë që qeveria shqiptare ka zhvilluar bisedime me IVECO-n dhe kompani të tjera italiane, por ato janë kushtëzuar të zgjedhin si kontraktorë KAYO-n dhe Ron Yeffet?”, pyeti Tabaku.

Ajo e lidhi çështjen me mënyrën se si, sipas saj, po menaxhohen asetet dhe fondet publike në sektorin e mbrojtjes, duke ngritur pikëpyetje mbi procedurat e përzgjedhjes së operatorëve, konkurrencën dhe përdorimin e ndihmës shtetërore.

Tabaku përmendi gjithashtu shifrën prej **34 milionë eurosh**, që sipas saj janë dhënë KAYO-s brenda dhjetë muajve nga fondet publike, duke kërkuar transparencë mbi mënyrën se si janë negociuar kontratat dhe si është verifikuar aftësia financiare dhe profesionale e kompanive të përfshira.

Lexo edhe:[‘A është përdorur Shqipëria për trafik armësh?’/ Tomorri: Përgjimi është i vërtetë](#)[Pagat e magistratëve/ Asociacioni Evropian i Gjyqtarëve: Po shkelet vendimi i Kushtetueses](#)**TË GJITHA**

Tabaku: A ndaluan shërbimet e NATO bashkëpunimin e kompanive italiane me Ron Yeffet e Kayo?

19:47 : 17/09/2026



“Populli pa bukë, Belinda me vila”, pankartat e protestës së 110-të

19:46 : 17/09/2026



“Të plasi trapi...”/ Çfarë zbulojnë email-et e Ballukut për vilën në Green Coast

19:36 : 17/09/2026



110 ditë në rrugë, protestuesit përsërisin kërkesën: Rama jep dorëheqjen

19:26 : 17/09/2026



SPAK nis hetim për çështjen e pagave të magistratëve

19:17 : 17/09/2026



Federata angleze sfidon Infantinon dhe kërkon hetim për dy çështjet që tronditën FIFA-n

19:10 : 17/09/2026



‘A është përdorur Shqipëria për trafik armësh?’/ Tomorri: Përgjimi është i vërtetë

19:01 : 17/09/2026

[View this post on Instagram](#)

Tabaku: KAYO tregoi se në Shqipëri, sipas këtij modeli, nuk ka rëndësi si bën biznes apo sa ke investuar. Për të ecur përpara duhet të njohësh një njeri që quhet Edi Rama. Asetet dhe financat publike janë nën sulmin e modelit KAYO. Ndërkohë që një familje mezi numëron lekët për faturat e ushqimeve dhe çmimin e naftës, 34 milionë euro nga taksat e shqiptarëve i jepen KAYO-s pa kontrollin dhe monitorimin e duhur, ndërsa pretendohet se po zhvillohet industria e mbrojtjes.

Pak muaj më parë shkova te familja Dervishi. Brenda natës, sipas asaj që më treguan, iu mor prona. Qeveria kishte vendosur që aty të ndërtohej fabrika e KAYO-s dhe familja u gjend pa pasuri. Ndërkohë, pasuri private dhe publike iu vunë në dispozicion një kompanie ku, sipas të dhënave që ne kemi, shteti zotëron më pak se 50 për qind. Si u përzgjedhën këta operatorë? Si u negociuan drejtpërdrejt kontratat? Si u garantua konkurrenca? Si u përdor ndihma shtetërore? Si u verifikua aftësia e individëve për të investuar në fushën e mbrojtjes? Cila është vlera reale e shtuar nga ky projekt, përtej 34 milionë eurove që, sipas nesh, kanë shkuar te një njeri i afërt me kryeministrin? Të gjitha këto pyetje lidhen edhe me detyrimet tona në procesin e integritetit evropian, veçanërisht për transparencën dhe prokurimin publik.

Duhet të dimë si është e mundur që, sipas shifrave që kemi, 34 milionë euro nga taksat e shqiptarëve t'i jenë dhënë KAYO-s brenda dhjetë muajve. Ky nuk është rasti i parë.

Prandaj kam një kërkesë dhe një pyetje për ministrin e Mbrojtjes: A është e vërtetë që qeveria shqiptare ka zhvilluar bisedime me IVECO-n dhe kompani të tjera italiane, por ato janë kushtëzuar të zgjedhin si kontraktorë KAYO-n dhe Ron Yeffet?

Etiketa: Jorida Tabaku Kayo qeveria Ron Yeffet

Lajme të lidhura



'A është përdorur Shqipëria për trafik armësh?'/ Tomorri: Përgjimi është i vërtetë

19:01 : 17/09/2026



Pagat e magistratëve/ Asociacioni Evropian i Gjyqtarëve: Po shkelet vendimi i Kushtetueses

17:06 : 17/09/2026



Vera 2026/ Mes premtimeve për siguri dhe 19 viktimize

16:47 : 17/09/2026



Tabaku: Kuvendi rrëzoi komisionin për KAYO-n, PD do ta çojë çështjen në Kushtetuese

13:57 : 17/09/2026



Debatet në mbledhjen pa media/ Tabaku në Konferencën e Kryetarëve: Pikëpyetje mbi veprimtarinë e KAYO

10:12 : 17/09/2026



Konferenca e Kryetarëve, PS rrëzon kërkesën e PD për Komision Hetimor për KAYO

09:51 : 17/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.